



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.483/2022
Datë: 14 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 10, paragrafi 5 i Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, duke vendosur lidhur për bashkim të procedurës disiplinore të panelit hetimor të themeluar me vendim KGJK/422/2022, në mbledhjen e mbajtur me datë 14 dhjetor 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Bashkohet procedura disiplinore për lëndën Nr.AD/KGJK/18/2022/GJTHGJA-AD/GJTHGJA.nr.20/2022 me lëndën Nr.AD/KGJK/22/2022/GJTHGJA-AD/GJTHGJA.nr.22/22.
- II. Procedura disiplinore e bashkuar për këto lëndë, do të zhvillohet nga paneli hetimor i themeluar me vendim të Këshillit me numër KGJK. nr.422/2022, i datës 03 nëntor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 6 dhjetor 2022, ka pranuar nga Autoriteti Kompetente i Gjykatës Themelore në Gjakovë, kërkesën AD/GJTHGJA.nr.22/2022 për fillimin e hetimit disiplinor.

KGJK, me vendimin KGJK.nr.422/2022, të datës 3 nëntor 2022, ka themeluar panelin hetimor për rastin disiplinor me Nr.AD/KGJK/18/2022/GJTHGJA-AD/GJTHGJA.nr.20/2022, ku si subjekt i hetimit në këtë procedurë disiplinore është gjyqtarja e Gjykatës Themelore në Gjakovë, Afijete Sada. KGJK duke shqyrtuar kërkesën e Autoritetit Kompetent të Gjykatës Themelore në Gjakovë, të datës 6 dhjetor 2022, konstatoi se meqenëse kemi të bëjmë me të njëjtin subjekt të hetimit dhe me të njëjtën shkelje disiplinore të pretenduar, si në aspektin e gjendjes materiali, ashtu edhe në kualifikimin juridik të njëjtë, vendosi të bashkoj procedurat disiplinore, e gjithë kjo me qëllim të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Andaj, nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kopje e vendimit i dërgohet:
- Panelit hetimor.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

